



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF
SHTIME

Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Data/ Datum/Date	23.12.2022
Nr/Br/ No	08/22
Për/Za/To	Kryetarin e Komunës: Qemajl Aliu
Nga/Od/From	Drejtori i Shërbimeve Publike: Bardhyl Rushiti
Lënda/Predmet/Subject	Raporti i punës i DSHP-së

Përshkrimi i detyrave

1. Zbatimin e ligjeve që kanë të bëjnë me ofrimin e kushteve optimale për popullatën në lëmin e shërbimeve publike, nëpërmjet ndërmarrjeve publike dhe institucioneve tjera që menaxhojnë dhe kujdesen për ofrimin e këtyre shërbimeve;
2. Furnizim me ujë të pijes;
3. Menaxhimin e sistemit të kanalizimit;
4. Menaxhimin e mbeturinave;
5. Menaxhimin e investimeve kapitale në infrastrukturën publike;
6. Pastrimin, larjen dhe largimin e borës dhe akullit nga rrugët dhe trotualet;
7. Sigurimin e mirëmbajtjes së parqeve, hapësirave publike dhe varrezave;
8. Funksionimin e tregjeve;
9. Ofrimin e shërbimeve lokale dhe të infrastrukturës duke përfshirë ujësjellësin dhe kanalizimin, përpunimin e ujërave të zeza, rregullimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe transportin lokal;
10. Kujdesin për trajtimin e ujërave të zeza dhe mbeturinave të ngurta;
11. Planifikimin e nevojave shpenzuese dhe investuese të Drejtorisë.

Aktivitetet

Sa i përket detyrave dhe përgjegjësi të DSHP-së brenda gjashtë muajve të parë të vitit 2022 janë realizuar këto punë si në vijim:

Aktiviteti i Inspektoreve ka qenë i fokusuar në inspektime kryesisht në fushën: tregtare, prodhuese, përpunuese, mbrojtje të ambientit, ndërtimtari, shërbime publike dhe komunikacion. Detyra e Drejtorisë është zbatimi i ligjeve dhe i të gjitha akteve nënligjore të nxjerra nga Ministritë përkatëse, dhe rregulloret e ndryshme të nivelit qendror apo lokal. Duke i zbatuar në praktik këto ligje ne kemi arritur që ta parandalojmë shumicën e veprimeve që kanë qenë ilegale dhe në kundërshtim me dispozitat e këtyre ligjeve në të gjitha fushat: tregti, bujqësi, shëndetësi, komunikacion, shërbime publike, mbrojtje të ambientit duke i aplikuar masa ndëshkimore si: Aktvendim urdhri, Gjobë mandatorë, Fletëparaqitje në Gjykatë.

Krejt këto me qëllim që qytetari të ketë një jetë më të shëndetshme, një ambient më të pastër, një qarkullim më të lirë apo me një fjalë një jetë më të mirë.

Raporti nga Sektori i Inspektoriatit

Raporti i punës nga inspektoriat i Bujqësisë, ndërtimtarisë (UD) vijon:

Në këtë kohë kam bërë 268 inspektime me këto veprime;

Procesverbale 114

Aktvendime 33

Fillim procedure në gjykatë 15

Fletë thirrje 3

Inspektim i fazave ndërtimore 16

Bashkpunim me inspektorin e Tregut 83

Me inspektoren e mjedisit 9

Përgjegjësi pale 4

Në këtë periudhë kemi bërë inspektime në ndërtimtarinë, duke përpiluar Procesverbale, aktvendime dhe fillim procedure për Gjykatë, njëjshu dhe përgjegjësi në kërkesë, dhe inspektimin armirimin e pllakave të ndërtësive. Kemi bërë edhe në bujqësi në tokat Bujqësore, monitorimin e korrjeve shirjes, monitorimin e smundjeve të bimëve dhe shtazëve, si dhe fermat e shpezëve njëjshu dhe fidanishtet duke shkruar, procese, aktvendime dhe për Gjykatë, si dhe kemi kryer punë ekipore të ndryshme edhe në bashkpunim me polici.

Pastaj me bashkpunim me inspektorin tregut dhe mjedisit, kemi inspektuar lokale dhe vende tjera si deponi mbeturinave dhe shqyrtimin e lëndëve të palve.

Njëjshu edhe inspektime pa proces verbal, pritje dhe sugjerime palve në zyrë.

Raporti i punës nga Inspektoriat i Tregut vijon:

1.Mbrenda këtyre muajve kam kryer 153 inspektime;me procesverbal në lamin e tregut.2.Procesverbale në bashkëpunim me Inspektorin e bujqësisë dhe ndërtimit 50 inspektime. 3.Akvendime urdhëri 12(subjekte të pa rregjistruara). Pas akvendimit i kanë eliminuar paregullsitë kanë rregjistruar subjektet afariste. 4 .Akvendim dënimi(Gjoha) 12 subjekteve afariste që kanë pasur parregullsi.7.Pelqime për punë 33 Për kushtet minimale higjeno- teknike.8.Kam kryer edhe punë tjera me urdhërin e eprorit në bashkëpunim me bordin e inspektorëve.

Inspektore për Mjedis dhe Ambient në kuadër të detyrave dhe përgjegjësi gjatë vitit 2022 ka realizuar këto detyra të punës:

Inspektime të vazhdueshme në teren ku janë përfshirë ndotësit mjedisor të natyrave të ndryshme e të cilit në një mënyrë apo tjetër kanë shkaktuar ndotje mjedisore.

Numri procesverbaleve të hartuara për periudhën Janar-Dhjetor 2022 gjithsej 70 procesverbale;

Aktvendime 5;

Numri i gjobave të shqiptuara gjithsej 5;

Shuma e gjobave të shqiptuara 1400€;

Ankesa dhe Kërkesa të parashtruara nga palët gjithsej 14;

Fillim i procedurave për Kundervajtje -Gjykata themelore Ferizaj gjithsej 0.

Sekretare e Komisionit për Vlerësim të dëmeve nga FN dhe FT numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara nga palët 79;

Raportim për Performancën Komunale në fushat Mbrotje e Mjedisit, Menaxhim i Mbeturinave, Ujësjellës dhe Kanalizim për vitin 2021;

Anëtare e Komisionit për hartim të planit Lokal për Menaxhim të Mbeturinave (rishikim të planit);

Plotësim i të dhënave për Raportin e Integriteteve Evropiane për sektorin e Inspektoratit;

Me Vendim të Kryetarit të Komunës prej datë: 10.11.2022-10.02.2022 kam kaluar në detyrën e Inspektorit të Ndërtimit.

Inspektori për Sherbime Publike dhe Komunikacion

Vijon: Kam pranuar 77 kërkesa të natyrave të ndryshme prej të cilave:

- 10 Kërkesa për leje qarkullimi në zonën urbane
- 8 Kërkesa për dhënjën e pëlqimit për shfrytëzimin e hapasirës publike
- 3 Kërkesa për dhënjën e pëlqimit për bllokimin e njërit shirit rrugor
- 5 Kërkesa për asistim Policisë së Kosovës- Stacioni Policor Shtet

- 3 Kontrata per shfrytezimin e hapsires publike (shfrytezim I poligonit nga autoshkolla)
- 3 Kërkesa DPUGJ, per hedhjen apo verifikimin e pikave kufitare
- 1 Raport për vend parkingjet në Komunën e Shtimes
- 1 Informatë Drejtorit
- Vendim për ndalimin e Komunikacionit në qendër dhe në rrugën "Tahir Sinani"
- Barazimi me zyrën e finacave rreth takasave per automjete ETJ.
- 3 Kërkesa janë refuzuar
- Punët tjera të pengesave në kanalizim për gjatë tër vitit
- Pritja dhe këshillimi, udhëzimi apo sugjerimi o palëve rreth kërkesave të tyre
- Punë të ndryshme si transporti publik I udhëtarave dhe caktimi I vendparkingjeve për autotaxi.

Zyrtari për eficiency

PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth ecurisë së punës për muajt raportues (Janar-Dhjetor)

Detyra e zyrtarit për Eficiency të Energjisë

- Kam raportuar në Agjencionin e Kosovës për Eficiency të Energjisë lidhur me PKVEE dhe implementimin e projekteve që lidhen me masat për eficiency.
- Kam përgaditur raportin për projektet e finalizuara për eficiency gjatë dy viteve të fundit, për AKEE dhe GIZ.
- Kam menaxhuar kontratën për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve lokale dhe kam përcjellë punimet që janë kryer në teren edhe në vazhdim po përgatitem për mirëmbajtjen dimërore.
- Është përfunduar me sukses furnizimi me lule dhe mbjellja e tyre nën mbikëqyrjen time të vazhdueshme si menaxher i kontratës.
- Me sukses të plotë është përfunduar edhe kontrata për rregullimin e varrezave të qytetit nën mbikëqyrjen time si menaxher i kontratës.
- Nën mbikëqyrjen time si menaxher, ka përfunduar edhe kontrata për rregullimin e ndriçimit publik në fshatin Pjetërshticë.
- Edhe kontrata për dekorimin e qytetit për festat e fund vitit ka përfunduar me sukses.
- Si dhe kontrata dy vjeçare për rregullimin e ndriçimit në varrezat e Dëshmorëve dhe Veteraneve në Mollopolc dhe Shtime, po vazhdon me dinamikën e parapara të punimeve. Punët e parapara për vitin 2022 kanë përfunduar dhe e njëjta kontratë do të vazhdojë edhe në vitin 2023.
- Kam pranuar kërkesa të reja kryesisht për dëmtime të ndryshme në ndriçim të rrugëve, ndriçim i ri.
- Kam kryer edhe punë të tjera me kërkesë të drejtorit, pagesa, specifikacione për fillimin e procedurave për projektet që janë të përcaktuara me planin e prokurimit.

- Tri projektet e fituara nga FKEE për financim në masa për eficiencë kemi nënshkruar Marrëveshjen për Shërbimet e Energjisë dhe për dy objekte kanë filluar punimet. Në shkollën “Emin Duraku” kanë përfunduar të gjitha punimet e brendshme dhe është lëshuar në funksion dhe po vazhdojnë punimet me ritëm të shpejt për të përfunduar edhe izolimet tjera të jashtme, ndërsa në shkollën “Naim Frashëri” po vazhdohet me punime të ngadalta por efektive për përfundimin e punimeve të brendshme për tu lëshuar në funksion.
- Kam ndjekur trajnimin e avancuar për menaxhimin e kontratave përmes e-prokurimit.
- Kam marr pjesë në takimin e KSDW për de karbonizim.
- Procesimin për pagesë të faturave të ndriçimit publik për çdo muaj.
- Si dhe punë të tjera ditore varësisht nga kërkesat e zyrtarëve komunal dhe palëve që kërkojnë këshilla dhe ndihmë, etj.

Detyra e zyrtarit për Menaxhim të Mbeturinave

- Në kuadër të detyrës së zyrtarit për Menaxhimin e Mbeturinave, kam marr pjesë aktive për përmbushjen e planit të zgjerimit dhe mbulueshmërisë për grumbullimin e mbeturinave.
- Kam mbajtur takime të rregullta me zyrtarët e kompanisë së mbeturinave.
- Raportim i rregullt për GIZ dhe organizatën CEDE lidhur me implementimin e planit operacional për shpërndarjen e kontenjerëve.
- Në proces të përfundimit është edhe Rregullorja e re për Menaxhimin e Mbeturinave ku kam dhënë një kontribut të çmuar.
- Kam pranuar 200 komposterë familjarë, donacion nga GIZ
- Në kuadër të kësaj detyre, bashkë me shefin e njësisë në Shtime të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave, kemi kryer identifikimin e deponive ilegale si dhe bashkërisht kemi futur në sistem të grumbullimit të mbeturinave një lagje shume të rëndësishme dhe problematike në fshatin Carralevë. Si dhe në mënyrë të organizuar po bëjmë shpërndarjen e kontejnerëve të për klientët e ri dhe vjetër.
- Me sukses kam arritur të përmbushë kriteret e përcaktuara për raportim në AMMK. Raporti është përfunduar dhe nënshkruar nga kryetari i komunës.
- Kam kryer pagesat e rregullta për mbeturinat komunale si menaxher i kontratës,
- Si dhe punë të tjera ditore varësisht nga kërkesat e zyrtarëve komunal dhe palëve që kërkojnë këshilla dhe ndihmë, etj.

Në kuadër të DSHP-së funksionin edhe Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim, bazuar në Ligjin për Fatkeqësi Natyrore dhe Fatkeqësitë e Tjera (FN&FT); Ligjit për Mbrojtje nga Zjarri, dhe përgjegjësive që ka, paraqet punën

dhe aktivitetet e ndërmarra dhe gjendjen momentale në komunën tone, pra edhe çështjen e sigurisë.

Për ngritjen e gatishmërisë emergjente si dhe sigurinë e qytetarëve të komunës së Shtimes, ZMSH-ja ka qenë e gatshme në dhënien e kontributit në rast nevojë kur paraqiten rastet nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë e tjera (FN&FT).

Në gjashtëmujorin e dytë 2022 Zyra për Mbrojtje dhe Shpëtim (ZMSH), është angazhuar në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve të parapara me Planin Vjetor të punës.

Në këtë periudhë ZMSH ka realizuar si prioritet:

- Koordinimin dhe bashkëpunimin me Institucionet e sigurisë, përgjegjësit e fshatrave ,institucioneve shëndetësore , Këshillin për siguri në fushën e emergjencave lokale etj.
- Inspektimet në ndërmarrjet publike dhe private për zbatimin e masave mbrojtëse dhe preventive.
- Bashkëpunimin dhe koordinimin me KFOR-in turk për sigurinë nga mjetet e pashpërthyerë për realizimin e projekteve të rrugëve në vendbanimet malore.
- Azhurimi dhe plotësimi i Dokumentit për vlerësimin e rrezikut, si dhe planet, operative për komunën e Shtimes.
- Analiza dhe vlerësimi i rreziqeve të ndodhura gjatë vitit 2022, në komunën e Shtimes.
- Evidentimi dhe kategorizimi i objekteve komunale që mund të shfrytëzohen për strehimore në rast rreziku për popullatën.
- Vlerësimi i dëmeve të shkaktuara nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera (konstatimi është se ka ulje të dëmeve për 35% krahasuar me vitin e kaluar- janë 84 kërkesa për vlerësim të dëmeve, në bujqësi dhe ekonomi familjare).
- Anëtar aktiv në Shtabin / emergjent, Lokal.
- Bashkëpunimi me policinë e stacionit të Shtimes rreth çështjes , zonat ku paraqesin rrezikë për banoret e komunës së Shtimes.
- Rekomandimet për evakuim të banorve në raste emergjente të rrezikut të lartë ,si dhe gjendja momentale e strehimoreve në Komunën e Shtimes.
- Rekomandim për rrezikun që paraqet liqeni akumulues “ Mjellma”.
- Rreziqet nga vërshimet dhe përmytjet-raportimet në KKSB.

- Raste të zjarrit nga të dhënat e brigadas së zjarrfiksave tregojnë se gjatëmuji i dytë ka përmisim të situatës, pra kemi zvoglim të rasteve për 40% .
- Edhe pse më pak raste aktive të covid 19, është përcjellur dhe është mbajtur nën kontrollë situata.

Aktivitetet tjera

Sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm gjendja në përgjithësi është e kënaqshme, por që kemi pasur dhe vështësi përshkak të prishjeve që kanë qenë në teren si dhe gjatë sezonës së verës. Ndërsa ujrat e zeza mirëmbahen nga “KRU Prishtina” kemi probleme të vazhdueshme në disa lagje dhe fshatra përshkak rrjetit jo të mirë. Por, edhe intervenime sipas kërkesave të qytetarëve në bashkëpunim me KRU(Kompaninë Regjionale të Ujësjellësit)

Menaxhimi i mbeturinave në Komunën e Shtimes bëhet nga KRM “Pastërtia”. KRM “Pastërtia” bënë mbledhjen dhe grumbullimin e mbeturinave nëpër vendbanimet e Komunës së Shtimes dhe mbledhja e mbeturinave të amvisërisë në Hapësirat e Hapura Publike.

Dinamika në realizimin e projekteve kapitale:

- ***“Rregullimi i ndriçimit publik”, janë duke vazhduar.***
- ***Rregullimi i varrezave të qytetit ka përfunduar si projekt..***
- = ***Rregullimi i parkut në Fshatin Petrovë është projekt dy vjeçar që ka filluar dhe do të përfundojë në vitin tjetër.***
- ***Rregullimi i ndriçimit publik të varrezave të Dëshmoreve dhe veteraneve në Shtime dhe Mollopolc faza e parë e projektit ka përfunduar por do të vazhdojë në vitin tjetër faza e dytë.***

Rregullimi i trotuareve, stazës për biçikleta, ndriçimit dhe gjelbërimit në rrugën Anton Çetta është projekt dy vjeçar që do të përfundojë në vitin tjetër. Faza e parë ka përfunduar

Vështësitë:

Vështësitë kanë qenë kryesisht të Mirëmbajtjes dhe Menaxhimit të Infrastrukturës, përshkak të problemeve të kontratave që i kemi gjetur pothuajse të shpenzuara nga ish pushteti i kaluar dhe kemi pasur ngecje të vazhdueshme. Për këtë arsyeje, fatkeqësisht, edhe përgjigjet nuk kanë qenë në kohë ndaj kërkesave të qytetarëve, e që kërkojmë mirëkuptim!